

Tri shfaqjet e "Die Jugend-Theater-Gruppe" në Berlin

Të rinjtë kundër konvencioneve të vjetra patriarkale

Në shfaqjen "Überleben" (Mbijetesa) merr pjesë edhe Teuta Selimi, me prejardhje nga Tetova. Ajo është vetëm 17 vjeçe, nxënëse e gjimnazit "Carl von Ossietzky", ku vijon mësimin në klasën e 11 në të njëjtën shkollë ku mësojnë edhe nxënësit që e përbëjnë grupin e këtij teatri. Teuta ashtu si dhe shumica e aktorëve e njej nga përditshmëria problematikën që rrah shfaqja: ballafaqimi i të rinjve që jetojnë në strukturat e mbyllura shoqërore me konvencionet sociale, morale etj.

Zejnullah Jakupi, Berlin

Në rendin e parë ka zënë vend udhëheqësja e Südost Europa Kultur e. V. Bosijlka Schedlich për të parë shfaqjen të iniciuar nga po ky institucion. Për tri ditë rresht, më 11 dhe 12 janar në teatrin Culture Rodeo në Kreuzberg të Berlinit, u dhanë shfaqje teatrore nga grupi i nxënësve i quajtur "Die Jugend-Theater-Gruppe" që funksionon tani pran qendrës Südost Europa Kultur e.V. projekt ky dedikuar integritetit të të rinjve berlinas. Në projekt marrin pjesë 12 anëtarë, të rinj dhe të reja nga 14 deri në moshën 18 vjeçare, që kanë prejardhje nga vende të ndryshme. Ekipin e të rinjve e udhëheq regjisori i teatrit profesionist Wolfgang B. Heine, pastaj muzikologë, kostumografë, skenaristë etj.

Shfaqja "Überleben" "Mbijetesa" është bazuar në librin "Frühlings Erwachen" (Zgjim pranveror) i autorit Frank Wedekind dhe me këtë rast duhet të thuhet se grupi i të rinjve e ka ndërtuar tekstin mbështetur në përvojat personale. Shfaqja, skenë pas skene, është ndërtuar dhe dokumentuar në mënyre filmike dhe fotografike.

"Frühlings Erwachen" trajton tematikën e ballafaqimit të të rinjve me konvencionet sociale, morale ku pasqyrohet përpjekja dhe ambiguiteti i individualitetit të të rinjve të cilët jetojnë akoma në strukturat e mbyllura shoqërore ku nuk mund të lëvizin jashtë normave strikte dhe sjelljeve morale si në shoqëritë e pra 100 viteve të cilat autori i merr në thumb të kritikës.

Udhëheqësja e südost Europa Kultur e. V. Bosijlka Schedlich thotë se kjo shfaqje është zhvilluar në kuadër të qendrës në fjalë dhe "ne jemi munduar të marrim ca ndihma financiare për të mbuluar provat e gjata. Nuk morëm shumë të holla por përmes angazhimit nga regjisori Wolfgang Heine, dhe ekipit të tij u bë e mundur që me të rinjtë nga 12 vende të ndryshme të japim këtë shfaqje. Këtu bëhet fjalë për problemet e të rinjve të cilët për herë të parë në jetën e tyre e zbulojnë seksualitetin e tyre dhe nuk dinë se çka të bëjnë, jeta e tyre është përplot sfida të cilave u nënshtrohen ata dhe shpesh nuk arrijnë t'i përballojnë ato. Të rinjtë nuk hasin në mirëkuptim në komunikimin e tyre me të rriturit, respektivisht prindërit", shpjegon z. Schedlich.

"Nga njëra anë të rinjtë janë kureshtarë t'i zbulojnë këto anë të jetës së tyre, një trysni për ta shijuar jetën në praktikë, e cila për disa bëhet e padurueshme, një rrugë pa krye e nga e cila nuk gjejnë rrugëdalje dhe shpesh bëjnë edhe vetëvrasje. Ndërsa disa të tjerë vdesin nga trysnia e prindërve apo e rrethit. Këtë më së miri e tregon fati i vajzës (në shfaqje) që kishte mbetur shtatzënë. Prindërit e saj nuk e pranuan një gjë të tillë. Nëna e vajzës i thoshte vajzës se babai nuk mund ta përballojë një turp të tillë që vajza e tij 14 vjeç të mbetet shtatzënë, andaj ajo e dërgon vajzën e saj për abort, me ç'rast vajza vdes në spital.

Të njëjtin fat ka edhe një djalosh i cili kishte rënë në provim dhe kishte frikë se për këtë dështim prindërit e tij do ta qortojnë e do të vuajnë nga disfata e tij.



Teuta Selimi jep një autograf



Pamje nga shfaqja




Regjisori Wolfgang B Heine (në mes) me Teutën dhe një aktor tjetër, pas shfaqjes

Informatë rreth shfaqjes

Shfaqja "Überleben" "Mbijetesa" është bazuar në librin "Frühlings Erwachen" (Zgjim pranveror) i autorit Frank Wedekind. Regjinë e ka bërë Wolfgang B. Heine. Disa nga aktorët kryesorë që kanë luajtur në shfaqje janë: Sohel Altan, Altan Gol, Simon Gyimah, Halina Jahnke, Aeneas Martens, Christina Rix, Sasun Firat Sayan, Teuta Selimi, Anja Vidaković Rosa Wannek, Zerah Wüstefeld etj.

"Kjo është një shfaqje që tregon se si duhet të sillemi me të rinjtë, me pak tolerancë dhe transparencë t'i shpëtojmë ata nga më e keqja", thotë Schedlich, dhe shpjegon tutje se të gjithë njerëzit i kanë këto probleme. "Të rinjtë mundohen të bëjnë çdo gjë që është e mundur që tu shkojnë për qejf prindërve dhe shpesh nuk arrijnë ta bëjnë këtë pikërisht sepse ata janë të rinj dhe mundohen ta zbulojnë seksualitetin, nga i cili ndërtohet një jetë e re. Kjo është edhe forca tek njerëzit, nënvizon z. Schedlich.

Në këtë shfaqje merr pjesë edhe një bashkëkombëse jona, Teuta Selimi, me prejardhje nga Tetova. Ajo është vetëm 17 vjeçe, nxënëse e gjimnazit "Carl von Ossietzky", ku vijon mësimin në klasën e 11 në të njëjtën shkollë ku mësojnë edhe nxënësit që e përbëjnë grupin e këtij teatri. Teuta



Pushka e parë e lirisë

FTESË

Bashkëkthetarët
Me rastin e 11 vjetorit të rënies së dëshmorëve të komitit Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahu, Edmond Hoxha, artisti Elbasan Isaili Hodo jep koncertin e tij recital me temë: "ZEMRA NËPËR LAPIDAR MË ËSHTE NDAR". Në këtë mbrëmje marrin pjesë z. Ilir Halilaj konsull pran ambasadës Shqiptare në Berlin. Regjisori i teatrit kombëtar z. Spiro Duni, moderon: Vjollca Hajdari zëdhënëse e RTK-së, përcjell këtë recital RTK.
Data 02.02. 2008 ora 19.
Këngëtar të njohur nga Kosova dhe Diaspora
Adresa: Fridrich wilhelm str.22 Minden
Këshilli organizativ . inf. 01739438510 01604109940

Më 1 shkurt 2008

Koncert bamirësie për Kosovën në Uels

Anëtarët e grupit koral Bridgend Male Voice Choir po përgatiten për një koncert të madh që do të ndihmojë viktimat e konfliktit. Të gjitha të hyrat nga ky koncert do t'i dhurohen shoqatës bamirëse "Hope and Direct" e cila bashkëpunon me Shoqatën Nëna Terezë në Kosovë.

Ky kor u formua në vitin 1999 me qëllim që të mbledhë para për viktimat e luftës në Ballkan. Gjatë katër viteve të fundit "Hope and Direct" kanë qenë të fokusuar në Kosovë, duke punuar me shoqatën Nëna Terezë, dhe kishte për qëllim të

ndihmonte refugjatët, personat e pastrehë, spitalet dhe shkollat.

Kori në fjalë, i cili jep koncerte me një repertor të gjerë për kauza të ndryshme gjatë vitit, tash ka pranuar të ndihmojë këtë shoqatë bamirëse.

Koncerti do të mbahet me 1 shkurt në Cowbridge Leisure Centre, The Bear Field, Cowbridge, Vale of Glamorgan, CF71 7DA. Biletat mund të blihen nga Alan Beckwith në 01446 775 836 apo nga Oli Bown në 01656 667 747.

(Nga Ukalbanians.org.)

Në Londër, më 10 shkurt 2008, organizuar nga Vetëvendosja

Dokumentar në përvjetorin e demonstratës së 10 shkurtit

Njoftojmë bashkatdhetarët se në kuadër të shënimit të përvjetorit të demonstratës së 10 Shkurtit 2007 në Prishtinë, dhe vrasjes së dy aktivistëve të saj, Lëvizja Vetëvendosje organizon shfaqjen e filmit dokumentar "10 Shkurti" nëpër të gjitha qendrat në Europë.

Ky film do të shfaqet në Swiss Cottage Community Centre, Adelaide Road, London NW3 3NR, të dielën me 10 Shkurt 2008, në ora 12.30. Hyrja është falas, mirëpo do të organizohet mbledhja e donacioneve për realizimin e projektit qendror - rregullimin e varrezave të dy dëshmorëve dhe ngritja e memorialit përkujtimor në Prishtinë.

Mirëpresim ardhjen tuaj!

Erzen Vraniqi, Qendra e lëvizjes Vetëvendosje për Britani të Madhe

në këtë shfaqje ka luajtur rolin e konferenciere-së dhe sufleres, ka bërë me mjaft mjeshtri hyrjen dhe përfundimin e shfaqjes. Ajo thotë se ka synime të bëhet aktore e vërtetë dhe të studiojë po këtë drejtim pas mbarimit të gjimnazit.

Teuta tregon se është angazhuar si 14 vjeçare në Workshope të vogla teatrore. Sa i përket tematikës së trajtuar në shfaqje ajo thotë se edhe prindërit e saj janë konservativë, ata do ta lejonin të martohet vetëm me shqiptar. "Por prindërit e mi nuk shqetësohen kur shohin skena të tilla, pasi e dinë se kjo ndodh vetëm në teatër, pra nuk brengosen. Km liri por jo kështu siç ndodh në shfaqje. Por sikur të më ndodhte një gjë e tillë në realitet ata do të më akceptonin dhe ky është edhe një mesazh për prindërit tjerë që të mos i vejnë fëmijët e tyre para aktit të kryer" thotë Teuta.

Njeriu që e ka pasur barrën kryesore e që është kujdesur që shfaqja të dalë mirë në gjitha aspektet është Wolfgang B. Heine. Ai thotë se e kishte shkruar këtë shfaqje para një viti kur ishte takuar këta të rinj. "Gjysmë viti e kemi improvizuar shfaqjen dhe pastaj gjatë pushimeve e kam përfunduar. Që nga fillimi e kemi ditur secili se kush do ta luaj cilin rol. Njëra prej më të guximshmeve që e pranoi rolin për të hapur shfaqjen dhe për të kënduar ishte Teuta, pra rolin e konferencieres, dhe kështu ndodhi. Ajo ka bërë edhe punën suflerit, një rol me

të vërtetë i vështirë epse ajo duhet të koncentrohet përplot 45 minuta", thotë Heine.

Në shfaqje merr pjesë edhe Rosa. Nëna e saj e përcjell shfaqjen me kujdes. Rosa thotë se në Gjermani ku jetojnë shumë të huaj ka edhe familje mjaftë konservative dhe për ta shfaqur është një temë tabu. "Unë jam kundër sjelljeve që i pamë në teatër, kjo nuk është zgjidhja", thotë ajo pas shfaqjes dhe shton: "në raste të tilla prindërit duhet të reagojnë për tu ndihmuar fëmijëve të tyre. Po qe se do të më ndodhte mua diçka e tillë nuk po them se prindërit e mi do të entuziazmoheshin nga kjo, por nuk do të sillen në atë mënyrë brutale. Për të pasur një shok në këtë moshë nuk është problem për prindërit e mi, ndërsa po të mbetesh shtatzënë (qesht) nëna do të më dëbonte nga shtëpia. Nëna e saj z. Wannek që kishte ardhur me vajzën e saj për ta parë shfaqjen tani po kthehet në shtëpi me metro. "Shfaqja më pëlqeu, thotë ajo, ndoshta ishte pak e gjatë, as unë nuk do të kisha pranuar sjellje të tilla si në shfaqje kundër fëmijëve të mi, e tmerrshme".

Edhe Rosa shpreson se do të vazhdojë të studiojë teatrin. Ndoshta do të angazhohet edhe në çështje sociale, mendon nëna e saj. Me këtë rast ajo porosit prindërit se fëmijëve duhet t'u qendrojmë pranë në momente të tilla, të nxjerrim mësim duke sjell vendime më të mira të mundshme për të mirën e tyre.